

**AKTI I THEMELIMIT
DHE
STATUTI I SHOQËRISË TREGTARE**

ALPHA PACK Sh.p.k.

Sot më datë 25.01.2025 , bazuar në vullnetin e lirë dhe në përputhje me ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar dhe Ligjit nr. 9723 date 03.05.2007 “Per Regjistrimin e Biznesit” i ndryshuar personat e poshtëshënuar:

1. **Alban Berisha**, i biri i Besimit lindur në Tiranë, me datë 02.05.1984, i identifikuar me leternjoftim Id 035849950 dhe me nr personal: I40502119H, banues në adresen: Rr “7 Marsi”, Banese private, godina nr 3, Tiranë,
2. **Erban Pelinku**, i biri i Aliut lindur në Tiranë me dt 23/04/1986, i identifikuar me leternjoftim Id 033988395 dhe me nr personal: I60423008V, banues në adresen: Rr “Asim Vokshi”, Pallati 220, Apt 22, Tiranë.

shpallin si më poshtë vijon:

Neni 1

Emërtimi

Formohet Shoqëria e quajtur **ALPHA PACK Sh.p.k** (në vijim do të quhet Shoqëria).

Neni 2

Forma Juridike

- 2.1. Shoqëria ALPHA PACK Sh.p.k, është person juridik i së drejtës shqiptare, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.
- 2.2. Shoqëria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.
- 2.3. Shoqëria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.
- 2.4. Shoqëria është një e tillë, kapitali i së cilës ndahet në kuota dhe që themelohet nga ortakët që përballojnë humbje vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të tyre në kapitalin themeltar.

Neni 3

Selia e Shoqërisë

- 3.1. Selia zyrtare e Shoqërisë Tregtare ALPHA PACK Sh.p.k. ndodhet ne adresen: **Koxhas, Qafzotaj, Shijak, Zona Kadastrale 2255, Nr i pasurine 20/39/ND1, Durrës, Shqipëri.**
- 3.2. Shoqëria Tregtare zhvillon aktivitetin e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë si dhe jashtë saj. Për këtë ajo mund të hapë edhe seli të tjera operative, filiale, përfaqësi dhe agjenci në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë si dhe jashtë saj, vetëm me vendim të ortakëve dhe në përputhje me ligjet e vendeve ku ato hapen.

Neni 4

Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e veprimtarisë ekonomike e Shoqërisë ALPHA PACK Sh.p.k është e pakufizuar. Ajo mund të shpërbëhet në çdo moment, sipas vendimeve të marra nga Asambleja e Përgjithshme.

Neni 5

Objekti i Veprimtarise

- 5.1 Veprimtaria kryesore e Shoqërisë do të përqëndrohet në fushën e prodhimit dhe tregtimit të ambalazheve prej letre e kartoni pa asnjë kufizim, si dhe përpunim e zhvillimin e tyre.
- Gjithashtu, shoqëria do te kryej aktivitete te tjera si më poshtë:
- a) përpunim ambalazhi industrial dhe ushqimor me leter dhe karton,
 - b) tregtisë pa kufizime me shumicë dhe pakicë, import -eksport.
 - e) Shërbime pa asnjë kufizim
- 5.2 Shoqëria kryen çdo lloj veprimtarie të dobishme për arritjen e objektivit te saj, duke përfshirë dhe pjesëmarrje në kuota dhe aksione në shoqëri dhe ndërmarrje te tjera.
- 5.3. Kjo Shoqëri mund të ndryshojë emërtimin e saj, vendqëndrimin, objektin e aktivitetit, të shtojë ortakë apo të rrisë kapitalin sipas vendimeve të Asamblesë së Përgjithshme.

Neni 6

Kapitali Themeltar

- 6.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është **5,000,000 Lekë (Pesë milion Lekë)** në vlerë monetare para. Numri i pjeseve (kuotave) të kapitalit është 2(dy) kuota. Pjesmarrja në përqindje me vlerë perkatesisht :
- 1. Ortaku themelues **Alban Berisha zotëron 51% të kapitalit shoqërisë**, nje pjese (kuote) me vlere 2,550,000 Lekë (dymilion e pesëqind e pesëdhjetë mije Lekë)

2. Ortaku themelues **Erban Pelinku zotëron 49% të kapitalit shoqërisë**, një pjese (kuote) me vlerë 2,450,000 Lekë (dymilion e katërqind e pesëdhjetë mijë Lekë)
- 6.2. Kapitali i premtuar, nënshkruhet dhe do të derdhet nga Ortaket e Shoqërisë.
- 6.3. Asnjë nga ortakët nuk mund të transferojë kuotat respektive që kanë në Shoqëri pa miratimin me shkrim të ortakëve të tjerë. Ky statut kushtëzon kalimin e kuotave të tretëve jashtë shoqërisë me miratimin e shoqërisë dhe të drejtëne parablerjes në favor të shoqërisë apo ortakëve të tjerë. Brenda 30 ditësh nga oferta për blerjen e kuotave nga ortakët e tjerë, ata duhet të vendosin nëse do ta blejnë kuotën apo nëse janë dakort për transferimin apo shitjen e saj tek një i tretë sipas kërkesës së ortakut shitës.
- 6.4. Asambleja e Përgjithshme vendos për zvogëlimin ose rritjen e kapitalit të Shoqërisë.

Neni 7

Transferimi i kapitalit

- 7.1. Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
 - b) shitblerjes;
 - c) trashëgimisë;
 - d) dhurimit;
 - e) çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj;
- 7.2. Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.
- 7.3. Ky statut kushtëzon kalimin e kuotave të tretëve jashtë shoqërisë me miratimin e shoqërisë dhe të drejtën e parablerjes në favor të shoqërisë apo ortakëve të tjerë.

Neni 8

Tërheqja e kapitalit

Ortaku i vetëm, me krijimin e kësaj Shoqërie pjesën e kapitalit të derdhur nuk mund ta tërheqë. Kjo bëhet vetëm pasi të nxirret bilanci i Shoqërisë për fitimin e realizuar.

Neni 9

Asambleja e Përgjithshme

Organi më i lartë i Shoqërisë është Asambleja e Përgjithshme, e cila mbledhet të paktën 1 herë në vit, dhe sa herë është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë. Asambleja e Përgjithshme ka kompetencat e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i Likujduesit dhe Audituesit Ligjor;

- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecures së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecures së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) Vendos për blerjen, shitjen, dhe transferimin e pasurive të paluajtshme të shoqërisë;
- j) Vendos në lidhje me çdo çështje të lidhur me pasurinë e shoqërisë, marrje hua, vendosje hipoteke, barrë siguruese etj.
- k) Vendos për pjesëmarrjen në shoqëri për hapje dege, filiale, zyra përfaqësimi etj.
- l) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti;

Neni 10

Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme

- 10.1. Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme, të shprehë vullnetin e tij dhe të votojë në përpjesëtim me pjesëmarrjen e tij në kuotat e Shoqërisë.
- 10.2. Secili ortak mund të caktojë një përfaqësues në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme. Përfaqësuesi mund të jetë një ortak tjetër ose një i tretë i autorizuar me shkrim.
- 10.3. Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme mund të mbahen brenda territorit të Republikës së Shqipërisë ose jashtë saj. Ortakët ose përfaqësuesit e tyre mund të marrin pjesë në mbledhjet e Asamblesë nëpërmjet mjeteve elektronike, duke përfshirë telekonferencat dhe/ose videokonferencat.
- 10.4. Asambleja e Përgjithshme thirret nga Administratori ose nga çdo ortak, në bazë të nenit 84 të ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”. Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme duhet të bëhet me njoftim me shkrim, nëpërmjet telefaksit ose letrës rekomande, apo nëpërmjet postës elektronike dhe i njoftohet të gjithë ortakëve të paktën 7 (shtatë) ditë përpara datës së përcaktuar për mbledhjen. Njoftimi duhet të përmbajë çështjet e ditës për diskutim, vendin, datën dhe orën e mbledhjes.
- 10.5. Për çështje të cilat vendosen me shumicë të thjeshtë votash, mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme do të jetë e vlefshme vetëm nëse në të marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që përfaqësojnë më shumë se 30% të kapitalit të Shoqërisë, në përputhje me nenin 86, pika , të ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.
- 10.6. Asambleja e Përgjithshme, për ndryshime në Aktin e Themelimit dhe Statutit, rritjen ose zvogëlimin e kapitalit, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe shpërbërjen e Shoqërisë,

vendos me $\frac{3}{4}$ e votave të ortakëve pjesëmarrës në mbledhje, në përputhje me nenin 87, pika , të ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.

Neni 11

Administrimi

- 11.1. Shoqëria do të administrohet nga administratorë, të emëruar për një periudhë maksimale prej 5 (pesë) vjetësh. Administratori caktohet në Statutin e Shoqërisë, dhe më pas emërohen, riemërohen ose shkarkohen nga Asambleja e Përgjithshme. Aktualisht, Shoqëria do të administrohet nga një Administrator.
- 11.2. Administratori gëzon të drejta të plota në drejtim të administrimit të Shoqërisë dhe mund të kryejë çdo veprim që e konsideron të nevojshëm për përmbushjen e objektit të Shoqërisë, përveç veprimeve që janë në kompetencë të Asamblesë së Përgjithshme apo të organeve të tjera të Shoqërisë. Administratori është përgjegjës për të gjitha veprimet e kryera gjatë administrimit të Shoqërisë dhe gjithashtu mund të caktojë përfaqësues për kryerjen e veprimeve për llogari të Shoqërisë. Në çdo rast, caktimi i përfaqësuesit nuk e përjashton Administratorin nga përgjegjësia.
- 11.3. Administratorët nuk mund të marrin borxhe nga Shoqëria apo të japin garanci në emër e për llogari të Shoqërisë në lidhje me borxhe apo investime të dhëna nga palë të treta.
- 11.4. Administratori do të veprojë gjithmonë në interesin më të mirë të Shoqërisë. Në rast konflikt interesi, Administratori do të njoftojë menjëherë ortakët, si dhe do të abstenojë nga përmbushja e ndonjë veprimi që lidhet me situatën e konfliktit të interesit deri në marrjen e udhëzimeve nga Asambleja e Përgjithshme.
- 11.5. Administrator i shoqërisë caktohet **Zt.Alban Berisha**, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë më datë 02.05.1984 dhe banues në Tiranë, në adresen: Rruga 7 Marsi, Banesë private, Godina nr 3, Njesia Administrative Kashar, Tiranë, Shqipëri, me nr personal **I40502119H** dhe nr karte identiteti **035849950**, për një periudhë 5 (pesë) vjeçare duke filluar nga dt 25 Janar 2025 deri me 24 Janar 2030.

Neni 12

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon në 1 Janar dhe mbyllet në 31 Dhjetor të çdo viti. Përjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 13

Kontrolli Financiar

Kontrolli financiar i Shoqërisë do të kryhet nga Eksperti Kontabël i Regjistruar konform legjislacionit shqiptar në fuqi. Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë Ekspert Kontabël të Regjistruar.

Neni 14

Bilanci Vjetor

Bilanci vjetor, raporti i administrimit, inventarët dhe llogaritë vjetore të hartuara nga Eksperti Kontabël i Regjistruar i nënshtrohen miratimit të Asamblesë së Përgjithshme brenda një afati prej 6 muajsh, duke filluar nga data e mbylljes së vitit financiar.

Neni 15

Dividenti

Në përputhje me dispozitat ligjore, Asambleja e Përgjithshme vendos mbi shpërndarjen e dividendit në bazë të rezultatit financiar të Shoqërisë.

Neni 16

Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë mes ortakëve të Shoqërisë, administratorit, likuidatorit, Shoqërisë dhe të tretëve, do të zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 17

Hartimi i Aktit

Ky Akt themelimi dhe Statut hartohet në 2 (dy) kopje në gjuhën italiane dhe në 2 (dy) kopje në gjuhën shqipe.

Neni 18

Dispozita te Pergjithshme

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin në përputhje me Aktin e Themelimit dhe Statutin, dhe me legjislacionin shqiptar në fuqi. Përsa nuk është shprehur në këtë Statut, do të zbatohet ligji nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

ORTAKER E SHOQËRISË

ALPHA PACK Shpk

ERBAN PELINKU

ALBAN BERISHA